10. Treguesit mjedisor të transportit

Ky sektor ndikon në cilësinë e përgjithshme të mjedisit, posaçërisht në mjediset urbane. Shumica e automjeteve përdorin naftën, çka nënkupton lirim të emisioneve në ajër, ujë dhe tokë. Gjithashtu, gjatë ndërtimit të rrugëve bëhen ndryshime të peizazhit dhe të tokave, përfshirë këtu edhe degradimin e mundshëm të habitateve. Automjetet e papërdorshme paraqesin po ashtu një rrezik serioz për mjedisin. Nga transporti i materieve të rrezikshme mund të vijë edhe deri të aksidentet me pasoja fatale për mjedisin.

10.1. Trafiku i pasagjerëve

Emri i treguesit	**Trafiku i pasagjerëve**
Kodi i treguesit	TR01
Lloji i treguesit sipas modelit DPSIR	Tregues i forcave shtytëse
Përshkrimi i treguesit	Treguesi paraqet sasinë e kilometrave të pasagjerëve (kmp) për një vit në Kosovë në lidhje me normën e rritjes së Bruto Prodhimit Vendor-BPV. Transporti tokësor përfshin transportin e udhëtarëve me rrugë dhe hekurudhë. Transporti Ajror nuk mbulohet nga buxheti. Treguesi gjithashtu përmban trafikun pasagjerësh tokë në përputhje me llojin e transportit që matet si përqindja e çdo lloji të transportit ne trafikun total pasagjerëve tokësor.
Metodologjia e përcaktimit të treguesit	Ndarja e kërkesës për transportin e udhëtarëve dhe BPV përcaktohen bazuar në vlerat indeksit, ku si një vit bazë merr 2000 (2000 = 100). Në këtë mënyrë ai mund të monitorojë shkallën e rritjes së kilometra pasagjerëve krahasuar me normën e rritjes së BPV -së.
Njësia matëse	- transporti tokësor përfshin transportin e pasagjereve rrugorë dhe pasagjereve te komunikacionit hekurudhor, dhe është shprehur në kilometra te pasagjereve (kmp) dhe /ose numrin e pasagjerëve (kmp) kur numri i kilometrave paraqet transportin e një pasagjeri ne një largësi prej një kilometri. - Bruto Prodhimit Vendor (BPV) është shprehur në çmime konstante (EUR). - kilometrat për pasagjer janë të shprehur në kmp, dhe ndarja e kërkesës pasagjerit dhe BPV përfaqëson një indeks (2000 = 100).
Burimi i të dhënave	Ministria e Infrastrukturës dhe Agjencioni i Statistikave të Kosovës
Dinamika kohore e mbledhjes së të dhënave	Në baza vjetore.

Ndërtimi i rrugëve ka ndikim të drejtpërdrejtë në mjedis për disa shkaqe ku ndër më kryesoret konsiderohen zënia e tokave bujqësore, gërryerjet dhe nxitja e erozionit të dheut, fragmentimi i habitateve natyrore, ndryshimi i regjimit ujor dhe aspektet tjera socio-mjedisore. Kosova ka 2311.7 km rrjet rrugor nga të cilat 1509.4 km janë regjionale, 665.2 km janë nacionale dhe 137.2 km janë auto udhë (figura 1).

Trendi i zgjerimit të infrastrukturës rrugore nga viti në vit është në rritje që bart në vete edhe rritjen e presionit në mjedis.



Figura 1: Gjatësia e rrugëve (km) sipas kategorive

Kosova ka 333 km rrjet hekurudhorë. Treni konsiderohet si transport më miqësorë me mjedisit sepse shfrytëzimi i tij zvogëlon nevojën për përdorimin e veturave për transport. Ndonëse në Kosovë, trenat janë të vjetër dhe kryesisht me lokomotiva që përdorin dizel mundë të thuhet që ky lloj transporti ka pasur ndikim pozitiv në reduktimin e ndotjes nga transporti në aspektin e përgjithshëm. Që nga viti 2005 kur ka filluar transporti hekurudhor i udhëtareve në Kosove e deri në vitin 2010 ka pasur rritje progresive të numrit të udhëtarëve që kanë shfrytëzuar trenin. Gjatë periudhës 2011-2014 ka qenë një numër konstant i udhëtarëve, ndërsa që gjatë periudhës 2015-2019 ka një rënie të numrit të udhëtarëve që kanë shfrytëzuar trenin për udhëtim (figura 2).



Figura 2: Trendi i shfrytëzimit të transportit hekurudhorë të udhëtarëve[1]

[1] *ASK, Statistikat e Transportit 2005-2018*

Fluturimet konsiderohen si një ndër burimet e shkarkimeve në ajër dhe të shkarkimeve të gazrave serrë. Kjo përfshinë sidomos periudhën e aterrimit dhe fluturimit të aeroplanëve ku gazrat shkarkohen në vendin nga fillon flurimi apo ku ndodhë aterrimi. Në Kosovë për transport ndërkombëtarë ajror shfrytëzohet Aeroporti Ndërkombëtarë "Adem Jashari". Sipas të dhënave të AN "Adem Jashari", për periudhën kohore 2006-2019 numri i udhëtarëve dhe numri i fluturimeve ka shënuar rritje progresive. Në figurën 3 është prezantuar trendi i udhëtarëve që kanë shfrytëzuar transportin ajror përmes AN "Adem Jashari". Nga figura shihet që nga rreth 90 mijë sa ishte numri i udhëtarëve në vitin 2006, në vitin 2019 është rritur në mbi 236 mijë udhëtarë.



Figura 3: Trendi i udhëtarëve në Aeroportin Ndërkombëtar Adem Jashari[2]

10.2. Transporti i mallrave

Emri i treguesit	**Transporti i mallrave**
Kodi i treguesit	TR02
Lloji i treguesit sipas modelit DPSIR	Tregues i forcave shtytëse
Përshkrimi i treguesit	Treguesi përfaqëson sasinë e realizuara kilometra ton (kmt) gjatë një viti në Kosovë në lidhje me normën e rritjes së BPV-së. Trafiku i mallrave duke përfshirë edhe transportin tokësor të mallrave me rrugore dhe hekurudhore. Treguesi gjithashtu përfshin trafikun e mallrave të tokësore sipas llojit të transportit që matet si përqindje e transportit rrugor dhe hekurudhor të mallrave në total për trafikun e mallrave të tokësore.
Metodologjia e përcaktimit të treguesit	Ndarja e kërkesës për transport të mallrave dhe BPV-së është bërë në bazë të vlerave të indeksit, ku si vit bazë është marrë viti 2000 (2000 = 100). Në këtë mënyrë ai mund të monitorojë ritmet e rritjes së kmt krahasim me normën e rritjes së BPV.

[2] *Aeroporti Ndërkombëtarë i Prishtinës "Adem Jashari"*

Njësia matëse	• transportit tokësor (transporti i mallrave me rrugë dhe hekurudhë) është shprehur në ton (t) dhe / ose ton-kilometra (kmt). Kmt është transporti i një toni ngarkesë në një distancë prej një kilometri • bruto prodhimi vendor (BPV) është shprehur në çmime konstante (EUR). • ton kilometrat e realizuara shprehen ktm, ndërsa ndarja e kërkesës për transportin e mallrave dhe BPV prezantohet përmes indeksit (2000 = 100).
Burimi i të dhënave	Ministria e Infrastrukturës dhe Agjencia e Statistikave të Kosovës
Dinamika kohore e mbledhjes së të dhënave	Në baza vjetore.

Ky tregues mjedisor ka për qëllim të vë në dukje presionin në mjedis që vjen nga sektori i transportit të mallrave e me theks të veçantë nga automjetet e rënda të transportit rrugor dhe njëkohësisht, kontributin që jep transporti hekurudhor në reduktimit e ndotjes përmes reduktimit të transportit rrugor të mallrave. Nuk ka të dhëna për transportin e mallrave përmes rrugëve tokësore, ndërsa sa i përket transportit të mallrave përmes rrugëve hekurudhore që nga viti 2011 e deri në vitin 2018, ka një rënie të sasisë së mallrave të transportuara përmes këtij transporti.



Figura 4: Sasia e mallrave të transportuara (mijë ton) përmes rrugëve hekurudhore

1.1. Mosha mesatare e mjeteve motorike

Emri i treguesit	Mosha mesatare e mjeteve motorike
Kodi i treguesit	TR03
Lloji i treguesit sipas modelit DPSIR	Tregues i presionit
Përshkrimi i treguesit	Treguesi paraqet moshën mesatare të automjeteve (motoçikletave, makinat e pasagjerëve, autobusë, kamionë dhe rimorkiot).
Metodologjia e përcaktimit të treguesit	Treguesi bazohet në të dhënat e regjistrimit të automjeteve për një vit të caktuar: për secilin automjet individual është llogaritur mosha në një mënyrë që data e prodhimit të automjetit zbritet nga data e regjistrimit. Mblidhen të gjitha vitet e automjetit ndahet me numrin e përgjithshëm të automjeteve.
Njësia matëse	Numri i viteve (vjetërsia)
Burimi i të dhënave	Ministria e Punëve të Brendshme, Ministria e Infrastrukturës dhe Agjencia e Statistikave të Kosovës
Dinamika kohore e mbledhjes së të dhënave	Në baza vjetore.

Mosha e automjeteve është një tregues mjedisor që tregon për presionin që i bëhet mjedisit nga këto burime të emetimeve të ndotësve në ajër dhe gazrave serrë. Sa më të vjetra që të jenë veturat dhe sa më i vjetër që është standardi EURO i tyre emetimet do të jenë më të larta dhe presioni do të jetë më i lartë.

Sa i përket vjetërsisë së veturave në Kosovë (tabela 1 dhe figura 5), numri më i madh i automjeteve nga të gjitha kategoritë i takon grupit që i takojnë standardit EURO3 dhe EURO4, dhe që mundë të konsiderohen si automjete të moshës mesatare. Pas këtyre kategorive vije kategoria e automjeteve para EURO1, që mundë të konsiderohen si automjete të vjetra, ndërsa që numri më i vogël i automjeteve që qarkullojnë në Kosovë i takon kategorisë EURO6, që mundë të konsiderohen automjete të reja.

Tabela 1: Numri i automjeteve të regjistruara sipas llojit dhe standardit Euro (2018)

	Para Euro1	Euro1	Euro2	Euro3	Euro4	Euro5	Euro6
Veturë për pasagjerë	50414	11622	35194	92342	61456	25267	9507
Automjet transporti i lehtë	5851	4808	11435	12695	6932	2055	464
Automjet transporti i rëndë	3372	1129	2476	3562	1011	857	210
Autobus	354	342	907	661	158	99	55
Motoçikleta	437	377	260	660	149	1	6



Figura 5: Numri total i veturave të regjistruara në Kosovë sipas standardit EURO

10.3. Numri i automjeteve

Emri i treguesit	**Numri i automjeteve**
Kodi i treguesit	TR04
Lloji i treguesit sipas modelit DPSIR	Tregues i presionit
Përshkrimi i treguesit	Ky tregues përfaqëson numrin e automjeteve në Kosovë, bazuar në të dhënat nga regjistrimi i automjeteve (motoçikletave, makinat e pasagjerëve dhe automjeteve komerciale), sipas llojit të karburantit (naftë, benzinë, gaz natyror, naftë, makina elektrike dhe automjetet hibride). Treguesi përfshin informacionin e mëposhtëm: - numri i mjeteve motorike sipas llojit; - numri i mjeteve motorike sipas llojit të lëndës djegëse; - përqindja e automjeteve të pasagjerëve që përdorin naftë në numrin e përgjithshëm të veturave të pasagjerëve; - numri i makinave të pasagjerëve për një mijë banorë;
Metodologjia e përcaktimit të treguesit	Ky tregues bazohet në numrin e automjeteve sipas llojit, numrin e automjeteve sipas karburantit, dhe vitin e regjistrimit të automjeteve.
Njësia matëse	- numri i mjeteve motorike sipas llojit; - numri i mjeteve motorike sipas llojit të lëndës djegëse; - përqindja (%) e mjeteve të pasagjerëve që përdorin naftë; numri i makinave të pasagjerëve / 1 000 banorë;
Burimi i të dhënave	Ministria e Punëve të Brendshme dhe Agjencia e Statistikave të Kosovës
Dinamika kohore e mbledhjes së të dhënave	Në baza vjetore.

Në Kosovë si mjet kryesorë i transportit përdoren veturat ku, kjo vjen si pasojë e mos funksionimit adekuat të transportit urban i cili operon me autobusë të vjetruar të cilët janë shumë të ngadalshëm dhe shkaktojnë shumë ndotje.

Numri i veturave është një tregues i rëndësishëm mjedisor meqenëse transporti është një nga burimet kryesore të ndotjes së ajrit dhe emetimeve të gazrave të serrës. Sikurse shihet nga figura tabela 2 dhe figura 6 që nga viti 2008 e deri në vitin 2019 ka pasur një rritje progresive të numrit të automjeteve në Kosovë. Nga kjo mundë të konkludohet që po ashtu ka pasur edhe një rritje të djegies së karburanteve nga këto makina që domosdoshmërish ka rritur edhe sasinë e ndotësve në ajër. Sa i përket numrit të veturave të pasagjerëve për 1000 banorë, Kosova në vitin 2019, kishte 291 makina për 1000 banorë.

Tabela 2: Numri i automjeteve sipas llojeve 2011-2019

Llojet e automjeteve	**2011**	**2012**	**2013**	**2014**	**2015**	**2016**	**2017**	**2018**	**2019**
Vetura	170321	176398	222537	236145	281847	260291	273862	280422	291292
Automjet transporti 3.5 dhe mbi 3.5 t	10877	11547	15352	15769	18330	17963	18559	33889	35157
Automjet transporti nën 3.5 t	17901	18225	24659	26949	30846	31285	32299	19371	19379
Kombibus	2698	2520	3225	3161	3212	2841	2535	2917	2977
Autobus	1117	1298	1570	1697	2124	1916	1949	2326	2135
Motoçikleta	546	809	1488	1540	1849	1790	1690	2038	2087
Traktorë	39	137	776	1036	941	613	523	1791	1851
Rimorkio nën 3.5 t	101	117	217	250	286	288	288	572	681000
Rimorkio 3.5 dhe mbi 3.5 t	1766	1800	2283	2281	2707	2628	2735	305	271000
Gjithsej	205366	212851	272107	288828	342142	319615	334440	343631	355829



Figura 6: Numri total i automjeteve të regjistruar në Kosovë 2008-2018[3]

[3] *Statistikat e transportit dhe telekomunikacionit 2015, ASK*

10.4. Numri i vdekjeve në aksidente rrugore

Emri i treguesit	**Numri i vdekjeve në aksidentet rrugore**
Kodi i treguesit	TR05
Lloji i treguesit sipas modelit DPSIR	Tregues i presionit
Përshkrimi i treguesit	Ky treguesi përfaqëson numrin e vdekjeve në aksidentet rrugore në Kosovë, numrin e njerëzve të lënduar në aksidente rrugore, dhe trendin. Ky treguesi monitorohet çdo vit, dhe shprehet në numra absolutë ose në 10 000 banorë.
Metodologjia e përcaktimit të treguesit	Numri i personave (të vdekur dhe të lënduar) në aksidente rrugore për çdo vit.
Njësia matëse	Numri i vdekjeve në aksidente rrugore. Numri i të lënduarve në aksidente rrugore.
Burimi i të dhënave	Ministria e Punëve të Brendshme dhe Agjencioni i Statistikave të Kosovës.
Dinamika kohore e mbledhjes së të dhënave	Në baza vjetore.

Bazuar në të dhënat e Policisë së Kosovës për periudhën kohore 2010-2019, aksidentet në trafikun rrugor dhe numri i personave të lënduar dhe të vdekur në këto aksidente kanë tendencë të rënies (tabela 3). Kjo mundë të ndërlidhet me përmirësimin e infrastrukturës rrugore, përmirësimin e sinjalistikës së rrugëve, rritjes së vetëdijes së ngasësve të veturave dhe pjesëmarrësve tjerë në komunikacion dhe efikasitetin e punës së Policisë së Kosovës.

Tabela 3: Aksidentet në trafikun rrugor në Kosovë dhe personat e vdekur në këto aksidente 2010-2019[4]

Viti	Aksidente me dëme materiale	Aksidente me lëndime	Aksidente me fatalitet	Persona të lënduar	Persona të vdekur
2010	12,594	4327	158	7731	175
2011	18,888	4490	130	8321	157
2012	19,756	4555	116	8561	121
2013	13,878	4960	104	9817	119
2014	10,333	4876	111	9713	127
2015	11,145	5275	117	10671	129
2016	12,312	6130	99	12009	110
2017	11,183	6390	122	12645	137
2018	9,424	6217	100	12360	129
2019	9,974	6148	100	11860	113

[4] *Strategjia e Sigurisë Rrugore dhe Plani i Veprimit në Kosovë (2016 –2020) dhe Raportet Vjetor të Policisë së Kosovës 2010-2019.*